



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
GUVERNATORI

Nr. 1481 prot.

Tiranë, më 02.04.2024

**VENDIM**

**Nr.1481 , datë 02.04.2024**

**PËR  
CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12, 14 dhe nenit 16, pika 1, shkronja “ç” dhe “d”, të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 për qind, dhe do të përmbushet duke filluar nga data 31 mars 2025.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse të kapitalit (SIST), përcaktohen si me poshtë:

<b>BARS</b>	<b>Vlerësimi për SIST-in total</b>	<b>SIST-i për periudhën 1 janar – 31 dhjetor, 2025</b>
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.5 për qind	1.5 për qind
Banka Credins sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka OTP Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2, të nenit 10,

pika 1, të rregullores 41/2019, ku vlera e KONS-it në vijimësi është në nivelin 2.5 për qind.

4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (*solo basis*).
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**Gent Sejko**